REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr. 8211/1 Prot.

Lushnje, më 22/08/2025

PROJEKT-VENDIM
Nr. 89
"MBI MIRATIMIN E PROJEKTEVE TË INVESTIMIT ME OBJEKT:

"Rikonstruksionin e godinës së Njësisë Administrative Krutje"
"Ndërhyrje në infrastrukturën e segmenteve rrugore në Çukas të Ri"
"Sistemim, asfaltim i rrugës së Trashallarëve në Ngurrëz të vogël"
"Sistemim, asfaltim i rrugës së Hoxhallarëve në Ardenicë"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës / /2025, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Zhvillimit urban dhe Rural, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në mbështetje të nenit 3 shkronja "d" dhe "e" nenit 23 pika 4, neni 40 pika 4 te ligjit nr 139/2015 datë 17.12.2025 "Për vetëqeverisjen vendore", Neni 40, neni 44 te ligjit nr 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në R.SH"-së i ndryshuar, pika 79, pika 100, pika 120 shkronja "d" të Udhëzimit nr.09 datë 20.03.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë "Për procedurat standartë të zbatimit të buxhetit". Neni 4, neni 5 pika 1.3, neni 21 të ligjit nr 107/2014 "Për planifimimin dhe zhvillimin e territorit":

PROPOZOJMË:

1.Të miratojë investimin me objekt:

- ""Rikonstruksionin e godinës së Njësisë Administrative Krutje" në vlerën 35,451,870.79 lekë
- "Ndërhyrje në infrastrukturën e segmenteve rrugore në Çukas të Ri" në vlerën 13,424,711 lekë
- "Sistemim, asfaltim i rrugës së Trashallarëve në Ngurrëz të Vogël" në vlerën 12,391,204.24 lekë
- "Sistemim, asfaltim i rrugës së Hoxhallarëve në Ardenicë" në vlerën 8,398,419.35 lekë

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Finance–Buxhetit, Zyra e Prokurimeve.

3.Vendimi hyn ne fuqi 10 (dhjete) ditë pas shpalljes.

DREJTORIA PLANIFIKIMIT TERRITORIT
Mimoza HAXHIU

DREJTORIA JURIDIKE
Bedri HIDA

DREJTORIA E FINANCË-BUXHETIT
Ervisa ÇUKO

KRYETAR I BASHKISË
Eriselda SEFA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJE

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA LUSHNJE
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT

Nr. 8211 **Prot.** **Lushnje,më** 22/08/**2025**

Relacion
Për miratimin e projekteve:
"Rikonstruksionin e godinës së Njësisë Administrative Krutje"
"Ndërhyrje në infrastrukturën e segmenteve rrugore në Çukas të Ri"
"Sistemim, asfaltim i rrugës së Trashallarëve në Ngurrëz të vogël"
"Sistemim, asfaltim i rrugës së Hoxhallarëve në Ardenicë"

KËSHILLIT TË BASHKISË LUSHNJE

Në mbledhjen e GMS-së të mbajtur në muajin Gusht me procesverbal nr 6 datë 04.08.2025 u diskutua dhe u konkludua në shpërndarjen e të ardhurave të trashëguara nga viti 2024 të cilat janë në vlerën 179,986,265 lekë nga kapitulli 01.
Duke patur në fokus kërkesat e qytetarëve të shprehura dhe në dëgjesat publike të ndërmarra për hartimin e buxhetit te vitit 2025, u dakortësua që një pjesë e fondeve të shkojë për zbatimin e projekteve : "Rikonstruksionin e godinës së Njësisë Administrative Krutje"; "Ndërhyrje në infrastrukturën e segmenteve rrugore në Çukas të Ri"; "Sistemim, asfaltim i rrugës së Trashallarëve në Ngurrëz të vogël"; "Sistemim , asfaltim i rrugës së Hoxhallarëve në Ardenicë" të cilat i sjellim për miratim.

Projekti: "Rikonstruksionin e godinës së Njësisë Administrative Krutje"
Ky project është hartuar në kuadër të rijetësimit të Qendrave të Njësive Administrative dhe nisur nga gjendja ekzistuese e godinës, e cila paraqet amortizim të konsiderueshëm në fasadë, dysheme, çati dhe instalime, duke mos përmbushur standardet e duhura për funksionalitet dhe siguri. Projekti parashikon ndërhyrje të mirëmbajtjes së zakonshme si shtresa të reja betoni e pllakash, dyer/dritare, suvaje, termoizolim, hidroizolim, çati, bojatisje, punime të ndryshme, hekur-beton, si dhe punime hidroteknike, elektrike dhe ngrohje-ftohje-ventilim, sistemim i jashtëm. Vlera e projektuar është 35,451,870.79 lekë

Projekti: "Ndërhyrje në infrastrukturën e segmenteve rrugore në Çukas të Ri"
Ky projekt përfshin segmentet rrugore:
1. Rruga "Miftar Kaja" – L = 363 ml, B = 3.0 m + 2×0.5 m bankinë

2. Rruga "Bixhekët" – L = 248 ml, B = 3.0 m + 2×0.5 m bankinë
3. Rruga "Degëzimi djathtas" – L = 96 ml, B = 3.0 m + 2×0.5 m bankinë

Parashikon sistemimin e tre segmenteve rrugore brenda Njësisë Administrative Allkaj, të cilat aktualisht ndodhen në gjendje të amortizuar dhe me vështirësi në qarkullim. Punimet kryesore që do të realizohen përfshijnë: Punime gërmimi dhe transport dherash; Shtrimin e shtresave bazë me çakëll dhe stabilizant; Vendosjen e shtresave të asfaltit (binder dhe asfaltobeton); Shtresa betoni në zona të caktuara; Ndërtimin e veprave të artit (tombino Ø500 mbi shtresë betoni).
Vlera e projektuar është 13 424 711 lekë.

Projekti: "Sistemim, asfaltim i rrugës së Trashallarëve në Ngurrëz të Vogël"

Ky project përfshin punime germimi dhe transporti; Punime shtresash betoni C16/20; Punime shtresash (stabilizime dhe skarifikime); - Punime asfaltimi (shtresë binderi); f.v tombino, në një segment me gjatësi 566 ml.
Profili tip ka permasat e seksionit terthor me gjerësi totale 3m +2*0.5m.
Vlera e projektuar është 12,391,204.24 lekë.

Projekti: "Sistemim, asfaltim i rrugës së Hoxhallarëve në Ardenicë"

Ky project përfshin punime germimi dhe transporti; Punime shtresash betoni C16/20; Punime shtresash (stabilizime dhe skarifikime); - Punime asfaltimi (shtresë binderi); f.v tombino fi 400 mm në një segment me gjatësi 515 ml
Profili tip ka permasat e seksionit terthor me gjeresi totale 3.5mm, me dy korsi
Vlera e projektuar është 8,398,419.35 lekë.

Bashkangjitur preventivat e punimeve dhe projektet

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

DREJTORIA PLANIFIKIMIT TERRITORIT
MIMOZA HAXHIU

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com